



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 222

Tiranë – E martë, 19 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 102/2017 datë 30.11.2017	Për një ndryshim në ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar..... 11849
Ligj nr. 103/2017 datë 30.11.2017	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar..... 11849
Ligj nr. 104/2017 datë 30.11.2017	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar..... 11852
Ligj nr. 105/2017 datë 30.11.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar..... 11852
Ligj nr. 106/2017 datë 30.11.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar..... 11853
Ligj nr. 107/2017 datë 30.11.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 11858
Ligj nr. 108/2017 datë 30.11.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 11858
Vendim i Kuvendit nr. 115/2017, datë 18.12.2017	Për caktimin e prokurorit që do të kryejë përkohësisht funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm..... 11866



LIGJ
Nr. 102/2017

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 171/2014, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 6, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve mbyllet në datën 31 dhjetor 2018.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10683, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 103/2017

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9981, DATË 8.9.2008, “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Nivelet tarifore të disa artikujve, të përcaktuara në lidhjen nr. 1, të ligjit nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, ndryshojnë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Miraturar në datën 30.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10684, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



Aneksi 1

Kodi sipas NKM 2017	Emërtimi	Tarifa doganore Ishte	Tarifa doganore Bëhet
321511	-- Të zeza	2%	0 %
321519	-- Të tjera	2%	0 %
321590	- Të tjera	2%	0 %
370130	- Pllaka dhe filma të tjerë, me çdo anë jo më tepër se 255 mm	2%	0 %
370199	-- Të tjera	2%	0 %
370500	Pllakat dhe filma fotografikë, të ekspozuar dhe të zhvilluar, përveçse filmat kinematografikë	2%	0 %
370790	- Të tjera	2%	0 %
	-- Zhvilluesit dhe fiksuesit	2%	0 %
390799	-- Të tjera	2%	0 %
391990	- Të tjera	6%	0 %
392310	- Kutitë, kasat, sëndukët dhe artikuj të ngjashëm	6%	0 %
591190	- Të tjera	10%	0 %
842381	-- Që kanë një kapacitet peshimi që nuk i kalon 30 kg	2%	0 %
	--- Që përdorin instrumente elektronike për të matur peshën		
844331	-- Makina të cilat kryejnë dy apo më shumë funksione printimi, kopjimi apo transmetim faksi, në gjendje për t' u lidhur me një makinë automatike të përpunimit të të dhënave apo me rrjetin	10%	0 %
844339	-- Të tjera	10%	0 %
	- Pjesët dhe plotësuesit		
844391	-- Pjesët dhe plotësuesit e makinave të printimit përdorur për printim nëpërmjet pllakave, cilindrave dhe komponentëve të tjerë të printimit të kreut 8442	10%	0 %
850490	- Pjesët	2%	0 %
	-- Të transformatorëve dhe inductorëve		
851821	-- Me një altoparlant, të montuar në të njëjtën rrethinë	10%	0 %
851822	-- Altoparlantët e shumëfishtë, të montuar në të njëjtën rrethinë	10%	0 %
851829	-- Të tjera	2%	0 %
851840	- Amplifikatorët elektrikë të audio-frekuencës	2%	0 %
851850	- Grupet elektrike të amplifikimit të tingullit	2%	0 %
851890	- Pjesët	2%	0 %
851981	-- Mjete komunikimi magnetike, optike ose gjysmëpërçuese	10%	0 %
	--- Aparate për riprodhimin e tingullit (përfshirë kasetofonat), jo e trupëzuar në një pajisje regjistruese		
851989	-- Të tjera	10%	0 %
852712	-- Radiokasetofon xhepi	2%	0 %
852713	-- Aparate të tjera të kombinuara me aparate regjistrimi apo riprodhimi të tingullit	2%	0 %
852719	-- Të tjera	2%	0 %
	- Marrësit radiotransmetues të paaftë për të operuar me një burim të jashtëm energjie, të një lloji të përdorur në mjetet me motor		
852721	-- Të kombinuara me aparatura të regjistrimit ose riprodhimit të tingullit	2%	0 %
	--- Në gjendje të marrin dhe dekodifikojnë sinjalet digjitale të Sistemit të të Dhënave të Radios		
852729	-- Të tjera	2%	0 %
	- Të tjera		
852791	-- Të kombinuara me aparatura regjistrimi ose riprodhimi të tingullit	2%	0 %
	--- Me një apo më shumë altoparlantë në të njëjtën karkasë		
852792	-- Jo të kombinuara me aparatura regjistrimi ose riprodhimit të tingullit por të kombinuar me një orë	2%	0 %
852799	-- Të tjera	2%	0 %



852849	-- Të tjera -- Monitorë të tjerë	2%	0 %
852871	-- Jo të projektuara për t' i trupëzuar një videoprojektor ose ekran --- Videot me buton stacionesh	10%	6 %
853180	-- Aparatura të tjera	10%	0 %
853630	-- Aparatura të tjera për mbrojtjen e qarqeve elektrike	10%	0 %
853710	-- Për një tension që nuk e kalon 1 000 V	2%	0 %
853810	-- Bordet, panelet, konsolat, tavolinat, kabineteve dhe bazave të tjera për mallrat e kreut 8537, jo të pajisura me aparaturat e tyre	2%	0 %
853939	-- Të tjera	10%	2 %
880260	-- Anijet e hapësirës (përfshirë satelitët) dhe mjete që lëshojnë anije të hapësirës dhe mjetet suborbitale --- Anijet e hapësirës (përfshirë satelitët)	2%	0 %
880390	-- Të tjera	2%	0 %
880521	-- Aeroplanët për stërvitje mësimore në tokë dhe pjesët e tyre	2%	0 %
880529	-- Të tjera	2%	0 %
900120	-- Fletët dhe pllaka prej materiali polarizues	2%	0 %
900190	-- Të tjera	2%	0 %
900219	-- Të tjera	2%	0 %
900220	-- Filtrat	2%	0 %
900290	-- Të tjera	2%	0 %
901050	-- Aparate dhe pajisje të tjera për laboratorë fotografikë (përfshirë kinematografikë), negatoskopet	10%	0 %
901060	-- Skenat e projektimit	10%	0 %
901090	-- Pjesët dhe plotësuesit	10%	0 %
901110	-- Mikroskopët stereoskopikë	2%	0 %
901180	-- Mikroskopë të tjerë	2%	0 %
901210	-- Mikroskopë të ndryshëm nga mikroskopët optikë dhe aparatet e difraksionit	2%	0 %
901290	-- Pjesët dhe plotësuesit	2%	0 %
901390	-- Pjesët dhe plotësuesit	2%	0 %
901410	-- Busullat për gjetjen e drejtimit	2%	0 %
901480	-- Instrumente dhe pajisje të tjera	2%	0 %
901490	-- Pjesët dhe plotësuesit	2%	0 %
901510	-- Largësimatësit	2%	0 %
901520	-- Teodolitet dhe takimet	2%	0 %
901540	-- Instrumente dhe pajisje tëurvejimit fotogrametrik	2%	0 %
901580	-- Instrumente dhe pajisje të tjera	2%	0 %
901590	-- Pjesët dhe plotësuesit	2%	0 %
902212	-- Aparate e kompjutera tomografike	2%	0 %
902229	-- Për përdorime të tjera	2%	0 %
902230	-- Tubat e rrezeve X	2%	0 %
902290	-- Të tjera, përfshirë pjesët dhe plotësuesit	2%	0 %
902519	-- Të tjera	2%	0 %
902590	-- Pjesët dhe plotësuesit	2%	0 %



LIGJ
Nr. 104/2017

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pika 5, fjalët “autovetura deri në 4+1” zëvendësohen me fjalët “autovetura deri në 6+1”.

Neni 2

Në nenin 11, pika 1, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) tarifa për veprime e shërbime të administratës së Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë;”.

Neni 3

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018, me përjashtim të nenit 2, që hyn në fuqi më 1 qershor 2018.

Miraturar në datën 30.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10685, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 105/2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Ministri përgjegjës për financat dhe ministri apo institucioni që ka në fushën e përgjegjësisë regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët kushtet, procedurat dhe metodologjinë për zbatimin e këtij neni.”.

Neni 2

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”. Përjashtimi nga tatimi mbi fitimin, i parashikuar sipas këtij paragrafi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2024. Efektet e përjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special.”.

2. Në paragrafin e fundit, fjalët “deri në shkronjën “f;” zëvendësohen me fjalët “deri në shkronjën “g;”.



Neni 3

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28
Shkalla tatimore

1. Tatimi mbi fitimin është 15%.

2. Për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitet për prodhimin/zhvillimin e *software*-ve, tatimi mbi fitimin është 5%. Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të *software*-ve, si dhe procedurat për zbatimin e këtij paragrafi.”

Neni 4

Në nenin 38, pika 7, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Të ardhurat e organizatorëve të lojërave të fatit taten me tarifën tatimore mbi të ardhurat bruto, sipas kuptimit dhe përcaktimit në ligjet respektive të fushës, ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 95/2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për lotarinë kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG Project”, sh.p.k.””.

Neni 5

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Miratuar në datën 30.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10686, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ

Nr. 106/2017

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006,
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE
VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 113, pika 1, shkronja “ç”, 155 dhe 157, pika 3, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. “Pasuri e paluajtshme” janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1. “Kadastra Fiskale” është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.”.

3. Pika 7 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 4, pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat. Struktura dhe organika miratohen me urdhër të Kryeministrit.

Këshilli i Ministrave miraton rregullat për organizimin dhe funksionimin e saj.”.



Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Ankimi

Ankimi i taksapaguesit në nivel vendor, kundër vendimit apo veprimt të zyrës së taksave, bëhet te struktura vendore e apelimit tatimor, sipas kritereve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak, në përputhje me nenin 4 të këtij ligji. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në gjykatë kundër vendimit të strukturës së apelimit tatimor në bashki.”.

Neni 4

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme - ndërtesa.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1 Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 2 dhe 2.1, që i bashkëngjiten këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.”.

3. Në pikën 3, fjalët “në anekset 1 e 2” zëvendësohen me fjalët “në aneksin 2”.

Neni 5

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22

Taksa mbi ndërtesat

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

6. Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;

b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;

ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;

d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;

dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;

ë) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;

f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.”.



Neni 6

Pas nenit 22 shtohen nenet 22/1, 22/2, 22/3, 22/4 dhe 22/5 me këtë përmbajtje:

“Neni 22/1

Baza e taksës

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

Neni 22/2

Shkalla e taksës

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Neni 22/3

Informacioni lidhur me taksën mbi ndërtesën

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla në lidhje me:

- a) natyrën dhe prioritetin e informacionit që do të përdoret në lidhje me përcaktimin e bazës së taksës mbi ndërtesat, në raste mospërputhjes të informacionit të marrë nga burime të ndryshme;
- b) prioritetin e të dhënave që do të përdoren në lidhje me vlerën e tatueshme.

Neni 22/4

Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë

Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë:

- a) menaxhon regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

b) udhëheq, nga pikëpamja metodologjike, në lidhje me administrimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme;

c) përcakton nivelin e vlerësuar të taksës së pasurisë së paluajtshme për ndërtesat, si dhe detyrimin e taksës së pronës, me metoda alternative të vlerësimit.

Këshilli i Ministrave vendos kritere dhe rregulla në lidhje me procedurat dhe elementet që përdoren për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

Neni 22/5

Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

- a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
- b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
- c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;
- ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimin të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;
- d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mbledhet nëpërmjet agentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave.

3. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin “Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.”.



Neni 7

Në nenin 27, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Përrjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtime e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”.”.

Neni 8

1. Aneksi nr. 7, “Taksa e tabelës” zëvendësohet me aneksin nr. 7 bashkëlidhur këtij ligji dhe bëhet pjesë përbërëse e tij.

2. Aneksi nr. 1, bashkëlidhur ligjit, me titull “Nivelet treguese të taksës së ndërtesës”, shfuqizohet.

Neni 9

Kudo në përmbajtje të ligjit bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Fjalët “ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, zëvendësohen me fjalët “ligjin

“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

2. Fjalët “ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, zëvendësohen me fjalët “ligjin “Për vetëqeverisjen vendore””.

Neni 10

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji, jo më vonë se një muaj nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 prill 2018, me përjashtim të nenit 7, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Miraturar në datën 30.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10687, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



Aneksi 7

TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashki Kat.I	Bashki Kat.II	Bashki Kat.III
I.	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)				
a	<i>deri në 2 m²</i>	lekë/m ² /vit	0	0	0
b	<i>-mbi 2 m² deri 10 m²</i>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	15 000	10 000	7 000
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	20 000	15 000	11 500
	-elektronike	lekë/m ² /vit	35 000	20 000	15 000
c	<i>mbi 10 m² deri 20 m²</i>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	12 750	8 500	5 950
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	17 000	12 750	9 775
	-elektronike	lekë/m ² /vit	29 750	17 000	12 750
ç	<i>mbi 20 m² deri 40 m²</i>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	8 250	5 500	3 850
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	11 000	8 250	6 325
	-elektronike	lekë/m ² /vit	19 250	11 000	8 250
d	<i>mbi 40 m²</i>				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	6 000	4 000	2 800
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	8 000	6 000	4 600
	-elektronike	lekë/m ² /vit	14 000	8 000	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim				
	-Tabela identifikuese	lekë/m ² /vit	120	120	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m²		Bashkia Tiranë	Bashkia Durrës dhe gjithë bashkitë e tjera të Kat.II	Bashkitë e Kat.III
	-e thjeshtë (me/pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	45 000	22 500	13 500
	-Elektronike	lekë/m ² /vit	90 000	45 000	27 000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.				
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m ² /ditë	1 000	1 000	1 000

Shënim: Bashkitë sipas kategorive ndahen:

Kategoria I: Tiranë, Durrës

Kategoria II: Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Pogradec, Sarandë, Lushnjë, Gjirokastrë, Lezhë, Krujë.

Kategoria III: Të gjithë bashkitë e tjera

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m² do t'i shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh., një tabelë të thjeshtë 15 m², shuma e taksës vetore do të llogaritet: (10 m² x 15 000 lekë) + (5 m² x 12 750 lekë) = 150 000 + 63 750 = 213 750 lekë në vit (ose 17 812 lekë/muaj). E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m² dhe mbi 40 m².

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.

Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m², do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m².

Në kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamje jo ballore, në tarraca, lozhë, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.



LIGJ
Nr. 107/2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN
MBI VLERËN E SHTUAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 49, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Përjashtimisht sa përcaktohet në pikën 3, të këtij neni, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 % aplikohet për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”.

Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 107, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të caktojë, me vendim, që për ndonjë kategori personash të tatueshëm, periudha tatimore të jetë më e gjatë se një muaj, por jo më e gjatë se një vit kalendarik.”.

Neni 3

Në nenin 109, në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Këshilli i Ministrave ka të drejtë të caktojë, me vendim, që për ndonjë kategori personash të

tatueshëm, regjistrat përmbledhës që shoqërojnë deklaratën e TVSH-së, të jenë për një periudhë më të gjatë se muaji, por jo më e gjatë se një vit kalendarik.”.

Neni 4

Në nenin 117, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në, rastet e përjashtimit apo kufiri minimal i regjistrimit për kategori të veçanta, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Miratuar në datën 30.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10688, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 108/2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 61/2012, “PËR AKCIZAT
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Kreu IX/1 “Pijet energjike” dhe nenet 77/1 dhe 77/2 shfuqizohen.

Neni 2

Në nenin 78, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:



“6. Nikotinë lëng, që klasifikohet në kodet 3824 99 56 dhe 3824 99 57 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, që përdoret për mbushjen e cigareve elektronike të klasifikuara në kodet e 8543 70 90 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave dhe për krijimin e një procesi tymosjeje.”.

Neni 3

Pas nenit 80 shtohet neni 80/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 80/1

Importimi dhe prodhimi i letërës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në kodin 4813 1000 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, kryhet përkundrejt marrjes së një autorizimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave nxjerr udhëzim për zbatim të këtij neni, lidhur me përcaktimin e kushteve, kritereve dhe afatin e autorizimit, si

dhe procedurën e monitorimit të importeve dhe prodhimit të letërës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave të letërës kundrejt sasisë së duhanit të importuar apo të blerë brenda vendit, në baza vjetore.”.

Neni 4

Shtojca nr. 1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, zëvendësohet me shtojcën nr. 1 bashkëlidhur dhe bëhet pjesë përbërëse e ligjit.

Neni 5

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Miratuar në datën 30.11.2017

Shpallur me dekretin nr. 10689, datë 15.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



SHTOJCA NR. 1
MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kategoria	Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla taksimit
I		KAFE	
C100 Kafe e papjekur	09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	0
C200 Kafe e pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	60 lekë/kg
C300 Lëkura, lëvoret zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 92 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg kafe
II		BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE	
B000 Birra	22 03	Birrë e bërë nga malto: - nga prodhues vendës e të huaj, ligjërishit dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të vogël se 200 000 HL në vit Nga prodhues vendës e të huaj, ligjërishit dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të madhe se 200 000 HL në vit	360 lekë/HL/ shkallë alkoolometrike 710 lekë/HL/ shkallë alkoolometrike
W200 Vera e qetë dhe pijet e qeta të fermentuara	22 04 21 22 04 29 22 04 30 22 04 30 10 22 04 30 96 22 04 30 98 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 10 22 06 00 59 22 06 00 89	Verë e qetë dhe musht rrushi; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese; pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të pagazuara. - nga prodhues vendës e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendës e të huaj me sasi > 10 000 hektolitër/vit	3 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe 4 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë 10 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe 12 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë
W300 Vera spumante, Shampanja dhe pijet e fermentuara dhe të gazuara	22 04 10 22 04 21 06 22 04 21 07 22 04 21 08	Verërat spumante, Shampanja; Verë ndryshe nga ato të nënkreut 220410, në shishe me tapa “kërpudhë” që lidhet me mbërthyes	5 200 lekë/HL



	22 04 21 09 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 39 22 06 00 31 22 06 00 51 22 06 00 81	apo tela; verë e ndërtuar ndryshe me një presion të pranueshëm në sajë të dyoksidit të karbonit. Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese të një force alkoolike ndaj volumit prej 18% apo më pak. Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të gazuara Cider dhe cider dardhe me përmbajtje alkooli 8,5%	3120 lekë/HL
I000 Pijet alkoolike të ndërmjetme	22 04 21 85 22 04 21 86 22 04 21 87 22 04 21 88 22 04 21 89 22 04 21 90 22 04 21 91 22 04 21 93 22 04 21 94 22 04 21 95 22 04 21 96 22 04 21 97 22 04 21 98 22 04 29 85 22 04 29 86 22 04 29 87 22 04 29 88 22 04 29 89 22 04 29 90 22 04 29 91 22 04 29 93 22 04 29 94 22 04 29 95 22 04 29 96 22 04 29 97 22 04 29 98 22 05 10 10 22 05 10 90 22 05 90 10 22 05 90 90 22 06 00 10 22 06 00 39 22 06 00 59 22 06 00 89	Pijet alkoolike të ndërmjetme me një forcë alkooli mbi 15% volum, por që nuk e kalon 22% volum Sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit	5 200 lekë/HL
S200 Pije alkoolike (Spirituous Beverages)	22042192 22042193 22042194 22042195 22042196 22042197 22042198 22042992 22042993	Pije alkoolike; të përfituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërsive të rrushit, Whisky, Rum dhe të tjera pije të përfituara nga distilimi i produkteve të fermentuara nga kallami i sheqerit, Gin dhe Geneva, Vodka, likere dhe tonike, Uzo - nga prodhues vendës e të huaj me sasi < = 20 000 hektolitër/vit	65 000 lekë për HL alkool anhidër



	22042994 22042995 22042996 22042997 22042998 22051090 22059090 22060010 22060039 22060059 22060089 22082012 22082014 22082026 22082027 22082029 22082040 22082062 22082064 22082086 22082087 22082089 22083011 22083019 22083030 22083041 22083049 22083061 22083069 22083071 22083079 22083082 22083088 22084011 22084031 22084039 22084051 22084091 22084099 22085011 22085019 22085091 22085099 22086011 22086019 22086091 22086099 22087010	- nga prodhues vendës e të huaj me sasi >20 000 hektolitër/vit	84 500 lekë për HL anhidër
--	--	--	----------------------------



	22087090 22089011 22089019 22089033 22089038 22089041 22089045 22089048 22089052 22089054 22089056 22089069 22089071 22089075 22089077 22089078		
S300 Alkooli etilik jo i denaturuar	22071000 22089091 22089099	Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% volum apo më shumë	45 000 lekë për HL alkool anhidër
S400 Alkool etilik i denaturuar	22072000	Alkool etilik i denaturuar	0 (zero)
S400 Rakia sipas përcaktimeve të nenit 66 të ligjit	22082029	Raki	20 000 lekë për HL alkool anhidër
S500 Produkte të tjera që përmbajnë alkool etilik	Kapitujt 17 deri 22 të NK	Të gjitha produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2 % ndaj volumit dhe pavarësisht klasifikimit në sistemin NK, sipas nenit 64 të ligjit	45 000 lekë për HL alkool anhidër
III DUHAN DHE NËNPRODUKTE TË TIJ			
T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	4400 lekë/kg
T200 Cigare që përmbajnë duhan	24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	5500 lekë/1000 copë Më 1 janar 2018 5850 lekë/1000 copë Më 1 janar 2019 6000 lekë/1000 copë Më 1 janar 2020 6250 lekë/1000 copë Më 1 janar 2021 6500 lekë/1000 copë
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	4400 lekë/kg
T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani Duhan i përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri	4400 lekë/kg 2500 lekë/kg



T401 Nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike, të përcaktuara në kode 85 43 70 90, të përdorura për krijimin e një procesi tymosjeje	38 24 99 56 38 24 99 57	Nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike, të përcaktuara në kode 85 43 70 90, të përdorura për krijimin e një procesi tymosjeje	10 lekë/ml
IV PRODUKTET ENERGJETIKE			
E200 Vajrat vegjetale dhe shtazore të klasifikuara në krrerët 1507 deri	1507 deri 1518	Vajrat dhe dhjamërat prej kafshëve apo vegjetale dhe produktet prej tyre	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
1518 të NK nëse përdoren për ngrohje apo motorë			
E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që u përkasin kodeve NK të kreut 2707	50 lekë/litri
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	50 lekë/litri
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	37 lekë/litri
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër me më pak se 98 oktan me 98 e më shumë oktan	50 lekë/litri
E430	27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21 deri 27 10 19 25	Vajguret Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri 20 lekë/litri
E440	27 10 19 31 deri 27 10 19 48	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri
E450	27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	37 lekë/kg
E460	2710 20	Biodiesel me vajra nafte	37 lekë/kg
E470	27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg
E471	27 109 100 deri 27109900	Mbetje vajrash	5 lekë/kg
E472	27 12 10 90	Graso	40 lekë/kg
E480	27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte	2 lekë/kg
E490	27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg



E492	27 14 10 00	Rëra bituminoze	2 lekë/kg
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpininën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (p.sh., asfalto-beton)	5 lekë/kg bitum
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjesh	8 lekë/litri
E501 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai si lëndë djegëse për motor automjesh	0 lekë/litri
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike	37 lekë/kg
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike	37 lekë/kg
E800 Metanol (Alkooli metilik)	29051100	Metanol (Alkooli metilik)	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi; Alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale Alkibenzenet e përziera dhe Alkinaftalenet e përziera	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore/Biodiezel me më pak se 70% vajra nafte të kapitullit 27	37 lekë/litri
V		FISHEKZJARRËT	
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
F000	36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg
VI		GOMAT	



P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	40 lekë/kg
P300 Goma të përdorura	40 12 20 00	Goma pneumatike të përdorura	100 lekë/kg
VII		PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË	
A100 Pilat dhe bateritë primare	85 06	Pilat dhe bateritë primare	200 lekë/kg
A200 Akumulatorët	85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshirë ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshirë katrorët)	20 lekë/kg
VIII LLAMBA INKANDESHENTE			
Y100 Llambat inkadeshente	85 39 22 10 85 39 22 90 85 39 29 92 85 39 29 98	Llambat reflektor Të tjera Më tepër se 100 V Jo më tepër se 100 V	100 lekë/copa 100 lekë/copa 100 lekë/copa 100 lekë/copa

**VENDIM
Nr. 115/2017**

**PËR CAKTIMIN E PROKURORIT QË DO
TË KRYEJË PËRKOHËSISHT
FUNKSIONET E PROKURORIT TË
PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 109, pika 2, të ligjit nr. 97/2016 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë’, dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Prokurorja, zonja Arta Ndrec Marku, caktohet të kryejë përkohësisht detyrën dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 18.12.2017

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax +355 4 24 27 004 Tel. +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë